



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008), nenit 27 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nr. 03/L-048, Nenit 32 paragrafi 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit Nr.06-103/1 i datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën 28.07.2023 pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, miraton këtë:

V E N D I M
PËR BARTJEN E MJETEVE VETANAKE TË PA SHPENZUARA NGA VITI 2022 NË VITIN 2023

Neni 1

Mjetet vetanake të vitit paraprak fondi 22 të vitit 2022 kapin shumën prej **86,651.56** euro.

Neni 2

Mjetet vetanake të pa shpenzuara nga **Neni 1**, i këtij vendimi në shume prej **86,651.56** euro, bartën në vitin 2023 dhe do të shpenzohen si në vijim të kësaj tablele.

| Nr | O.B. | Programi Buxhetor/nënprgami | Përshkrimi i Projektit | Kateg ..Bux hetor | Fondi | Shuma |
|----|------|--|---|-------------------------|-------|-----------|
| 1 | 621 | Administrata 163/16309 | Mallra dhe Shërbime | 13 | 22 | 5,931.35 |
| 2 | 621 | Shërbimet kulturore-Dragash 850/85009 | Subvencione | 20 | 22 | 768.08 |
| 3 | 621 | Planifikim Urban dhe inspeksioni 660/66350 | Ndërtimi i murit mbrojtës në rrugën Peterce në fshatin Radesh Projekti i ri | 30 | 22 | 10,000.00 |
| 4 | 621 | Planifikim Urban dhe inspeksioni 660/66350 | Asfaltimi i rrugës Kuklibeg- bjeshkë Projekti-51406 | 30 | 22 | 14,945.00 |

| | | | | | | |
|---|-----|---|--|----|----|------------------|
| 5 | 621 | Planifikim Urban dhe inspeksioni 660/66350 | Asfaltimi i rrugës Zlipotok-Glloboqicë-Baçkë-Brod Projekti 51401 | 30 | 22 | 17,596.82 |
| 6 | 621 | Planifikim Urban dhe inspeksioni 660/66350 | Rregullimi i rrjetit të ujsjellsit në fshatin Rapçë Projekti-50606 | 30 | 22 | 3,000.00 |
| 7 | 621 | Arsimi fillor 920/93240 | Ndërtimi i pllakës dhe kulmit si dhe renovimi i shkollës fillore 28 Nentori në fshatin Bresanë Projekti 51378 | 30 | 22 | 12,099.40 |
| 8 | 621 | Shërbimet e Shëndetësisë Primare 730/73550 | Blerja e automjeteve për QKMF në Dragash Projekti 52351 | 30 | 22 | 22,310.91 |
| | | | Totali | | | 86,651.56 |

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në protokollin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës së Dragashit, dhe do të implementohet përmes Ministrisë së Financave Departamenti i Buxhetit.

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

KRYESUESI I KUVENDIT

01Nr. 060/01-1661-2/23

Dt. 28.07.2023

Uran Halimi


